

## SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

Xhezair Zaganjori	Kryesues
Arjana Fullani	Anëtare
Andi Çeliku	Anëtar
Guxim Zenelaj	Anëtar
Admir Thanza	Anëtar

Mori në shqyrtim në seancë gjyqësore të datës 18.04.2017, çështjen administrative që i përket:

**PADITËS:** **Zhuljeta Laska (Bani);**

**I PADITUR:** **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Tiranë;**

**OBJEKTI I PADISË:** Detyrimin e palës së paditur për të më paguar shumën e lekëve (782 000 lekë), për periudhën nga data 12.02.2010 deri 17.01.2012 (23 muaj e 5 ditë), e cila përbën pagën si karteliste si dhe të gjitha detyrimet që rrjedhin prej saj, kontributet shëndetësore dhe shoqërore, vjetërsia në punë si dhe shpenzimet gjyqësore.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 32/a i K.Pr.Civile, neni 109 e vijues i K.Punës, Kreu XI paga, neni 44 i Kushtetutës.

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.6009 datë 30.05.2013 vendosi:** "Pranimin të kërkesë padisë. Detyrimin e të paditurit Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Tiranë që ti paguajë paditëses Zhuljeta Laska ( Bani) pagën e papaguar për periudhën e pezullimit në detyrë nga data 12.02.2010 deri me dt. 17.01.2012. Pagesa si me sipër do të bëhet në bazë të pagës të pozicionit të punës që paditësja ka pasur si karteliste në periudhën e pezullimit , pas pagimit të detyrimeve korresponduese mbi këtë pagë. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të paditurit".

**Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.2679 datë 19.12.2013 vendosi:** "Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë për shqyrtimin e çështjes nr.regj.them 4525 datë 12.09.2013. Dërgimin e çështjes për kompetencë shqyrtimi Gjykatës Administrative të Apelit".

**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr.111 datë 31.01.2014 vendosi:** "Lënien në fuqi të vendimit nr.6009 regjistri datë 30.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Shpenzimet gjyqësore nuk ka".

Kundër vendimit nr.111 datë 31.01.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ka ushtruar rekurs, brenda afatit ligjor, pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Tiranë, e cila kërkon ndryshimin e vendimeve dhe rrëzimin e padisë, duke parashtruar shkaqet e mëposhtme:

- Gjykatat kanë interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitat e Kodit të Punës.
- Urdhri i pezullimit ka qenë pa efekt financiar dhe marrëdhëniet janë ndërprerë për shkaqe të arsyeshme dhe ligjore.
- Paditësja mban përgjegjësi administrative pavarësisht faktit se ajo është shpallur e pafajshme nga gjykata.
- Në urdhrin pezullimit është evidentuar fakti se paditësja nuk do të paguhej si karteliste deri në përfundim të hetimit.
- Urdhri i pezullimit është akti administrativ në të cilin është evidentuar shkelja administrative.
- Fillimi i ndjekjes penale lidhet me shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit që i është bërë punonjësës Zhuljeta Laska.
- Ndaj paditëses nuk është marrë masë disiplinore por thjesht janë evidentuar shkelje të konsideruara të rënda gjatë ushtrimit të detyrës funksionale.
- Pala e paditur ka respektuar ligjin duke rikthyer paditësen në punë.

### V E N D O S I

**Lënien në fuqi të vendimit nr.111 datë 31.01.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë**

Tiranë, më 18.04.2017

**Nr. 31003-01587-00-2014 i Regj. Themeltar  
Nr. 00-2017- 541 i Vendimit (291)**